



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.140/5 prot.

Tiranë, 12.3.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 229, datë 28.01.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Banushi.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.02.2020 është njoftuar vendimi nr. 229, datë 28.01.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Banushi, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, nenit F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63 pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit z. Dritan Banushi ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetarit në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit duke filluar nga muaji Nëntor 1993 e në vijim, dhe aktualisht është gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Banushi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e tre kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si IKLD), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Dritan Banushi”² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr.84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Dritan *** Banushi, nr.*** prot., datë ***.05.2019³, ka referuar “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan *** Banushi”.

3.3 Inspektoriati i KLD, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Dritan Banushi.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi i thellë administrativ për*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI me nr. *** prot., datë ***.01.2018.

³ Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH nr.***, datë ***.05.2019.

⁴ Raport i IKLD nr.*** prot., datë ***.04.2018.

vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elementë të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe pas verifikimit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. [...] (f. 20 e vendimit).

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës. [...] (f. 21 e vendimit).*

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH” i ndryshuar, Komisioni pasi ka administruar raportin e përgatitur nga Inspektoriati i KLD, pas hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se: [...] *në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë indicie apo element që të cenonte figurën e gjyqtarit, sipas parashikimeve në nenin 44/a, të ligjit nr. 84/2016, duke arritur subjekti i rivlerësimit një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. [...] (f. 22 e vendimit).*

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër[...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tre institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër

vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik nga shqyrtimi i vendimit nr. 229/2020, çmon se ai është i cënueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtojmë edhe në vijim, i jemi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili bazuar në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar të këtyre çështjeve.

11. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, ndër të tjera, rrethana dhe fakte ligjore të evidentuara nga Komisioni, për të cilat iu kalua barra e provës subjektivit të rivlerësimit, lidhur me: (i) pamundësinë për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, shpenzimet e deklaruar dhe kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në *cash*, të deklaruar gjatë viteve të deklarimeve periodike vjetore; (ii) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarin e pasurisë në përdorim, apartament me sipërfaqe 85.5 m², ndodhur në Gjirokastër, si në deklarinet periodike vjetore (në vijim referuar si DV-) ashtu dhe në Deklaratën Vetting; (iii) mosjustifikimi i vërtetësisë së deklarimeve mbi gjëndjen faktike të apartamentit të blerë nga babai i subjektivit të rivlerësimit në momentin e blerjes, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

12. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

13. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të Aneksit të Kushtetutës si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 229, datë 28.01.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Kontrolli i pasurisë

14. Përsa i takon rivlerësimin të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimin, objekti i hetimit dhe i vlerësimin të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimin duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Rezulton se subjekti i rivlerësimin z. Dritan Banushi, është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI, deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003-2016 (në vijim DV 20..) dhe në datë 27.01.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr.2 të ligjit nr.84/2016.

16. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

17. Likuiditete në sistemin bankar dhe në cash. Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimin dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar likuiditete në sistemin bankar dhe në cash, të cilat, marrë në konsideratë natyrën e krijimit të deklaruar, janë trajtuar së bashku nga Komisioneri Publik, si më poshtë vijon:

17.1 Në D-Vett. subjekti i rivlerësimin ka deklaruar:

17.1.1 Depozitë me bashkëshorten (50 % secili) pranë “*** Bank”, në shumën 3.091.580,82 lekë, çelur në datë ***.12.2014, me burim krijimi: pakësim i gjendjes cash, deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve për periudhën 1994 – 2015.

17.1.2 Depozitë e subjektit (100%) pranë “Bankës ***.***”, në shumën 2.000.000 lekë, çelur në datë ***.12.2015, me burim krijimi: i) 1.500.000 lekë nga mbyllja e depozitës në “*** Bank” dhe ii) 500.000 lekë nga pakësimi i gjendjes cash, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve.

17.1.3 Depozitë e subjektit (100%) pranë “Bankës ***.***”, në shumën 700.000 lekë, çelur më ***.12.2016, me burim krijimi: i) pakësimi i gjendjes cash të deklaruar ndër vite, si dhe ii) nga kursimet për vitin 2016.

17.1.4 Gjendje cash, e cila më ***.01.2017 është në shumën 5.000 usd, krijuar me kursimet nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij ndër vite.

17.2 Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimin ka deklaruar: Llogari rrjedhëse pranë “Bankës ***.***”, me gjendje 7.714,68 lekë, më datë ***.01.2017.

17.3 Personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimin ka deklaruar: Depozitë pranë “***.*** Bank” në shumën 6.906,68 euro, e çelur në datë ***.03.2015, me burim krijimi: i)

Shuma dhuratë nga të afërmit me rastin e fitimit të shkollës së lartë në Universitetin ***
“***.***.*** ii) Pakësim i gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruar në vitin 2015, në
shumën 3.500 euro, iii) 450 euro të shtuara në llogari në datë ***.01.2016, si shumë e
grumbulluar nga të afërmit në festat e fundvitit dhe iv) 3.000 euro të dhuruara në datë
***.08.2016 nga xhaxhai.

17.4 Përsa i përket kursimeve vjetore në *cash*, që janë deklaruar si burim për krijimin e
depozitave të mësipërme, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave
periodike të pasurisë, duke filluar nga viti 2005 e në vazhdim deri në vitin 2016, ka deklaruar
posedimin e kursimeve *cash* në banesë, me burim të ardhurat nga paga e tij, paga e
bashkëshortës, si dhe dhurime në emër të vajzës së tij ***.***.

17.5 Në përfundim të hetimit administrativ nga analiza financiare, Komisionit i ka
rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e
deklaruara për vitet 2008, 2009, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 për një diferencë totale prej –
1.011.088 lekë. Për sa më sipër, Komisioni bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 i ka
kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me
rezultatet e hetimit.

17.6 Rezulton se Komisioni, pasi i vlerësoi pretendimet e subjektit në parashtrimet e tij të
datës 13.1.2020, i mori pjesërisht në konsideratë dhe ka konkluduar se subjekti nuk mbulon
me burime të ligjshme shumë prej – 152.670 lekë, për të cilën ka vlerësuar bazuar në
parimin e proporcionalitetit⁵.

17.7 *Komisionerit Publik*, nga analiza financiare lidhur me të ardhurat, shpenzimet dhe
kursimet e subjektit të rivlerësimit, e kryer sipas metodologjisë, trajtuar në pikën 18 më
poshtë, i rezulton se subjekti i rivlerësimit edhe pas provave të paraqitura Komisionit, nuk
mbulon me të ardhura të ligjshme *kursimet e tij të deklaruara* si më poshtë:

17.7.1 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të kursimeve në *cash* në vlerën
400.000 lekë, me burim krijimi, kursimet nga të ardhurat personale, si dhe pakësimin e gjithë
pasurisë për blerjen e autoveturës tip “Audi”. Bazuar në deklaratat e vetë subjektit të
rivlerësimit, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2007, rezulton
se kursimi i deklaruar nga subjekti në vitin 2007, së bashku me shpenzimet e atij viti, nuk
mbulohen me burime të ligjshme në shumën - 669.294 lekë.

17.7.2 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të kursimeve në *cash* në vlerën
700.000 lekë, me burim krijimi, kursimet nga të ardhurat personale. Nga analiza financiare e
të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon
me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e këtij viti për një diferencë negative prej –
130.193 lekë.

17.7.3 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të kursimeve në *cash* në vlerën
800.000 lekë, me burim krijimi, kursimet nga të ardhurat personale. Nga analiza financiare e
të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2009, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon
me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e këtij viti për një diferencë negative prej –
155.287 lekë;

⁵ Referohuni në faqen 20 të vendimit.

17.7.4 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 900.000 lekë, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat personale. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prindërit e tij, kanë mbuluar shpenzimet për pushimet vjetore në Angli të vajzës së tij. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratë noteriale të prindërve të tij, nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.04.2013. Theksojmë se këtë shpenzim dhe njëkohësisht të ardhur si dhuratë nga prindërit, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013, dhe as në pyetësonin nr.1 të Komisionit. Nëse këto të ardhura, nuk do të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, viti 2013 do të rezultonte me diferencë negative në shumën – 148.770 lekë.

17.7.5 Në DV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, me burim krijimi, kursimet nga të ardhurat personale, si dhe krijimin e depozitës bankare në vlerën 3.000.000 lekë, me burim krijimi, pakësimin e kursimeve në *cash*.

17.7.6 Në po të njëjtin vit (2014), rezulton se personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar vlerat 3.500 euro dhe 100.000 lekë, si shuma të dhuruara për fillimin e shkollës së lartë në Universitetin “***.***.***”, dhe njëkohësisht si shuma të disponuara *cash* në fund të këtij viti, të cilat në vitin pasardhës janë depozituar në llogarinë bankare të saj.

17.7.6.1 I pyetur nga Komisioni lidhur me identifikimin e dhuruesve dhe burimin e këtyre të ardhurave, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr.2 ka sqaruar: [...] “.... *Për shkak të shtrirjes në kohë të procesit të akumulimit, kohës që ka kaluar, si dhe numrit të madh të personave dhurues, nuk jam në gjendje të kujtoj dhe përcaktoj saktë të gjithë personat konkretë dhe as të individualizoj shumat e rastet konkrete për secilin person... Përsa i përket deklaratimit të burimit të të ardhurave përshkrimi i vajzës nuk është formuluar saktë, duke deklaruar që shumat 3.500 euro dhe 100.000 lekë, janë produkt i dhuratave monetare bërë vajzës për evente të ndryshme....*”[...].

17.7.7 **Komisioneri Publik**, konstaton që ka mospërputhje në deklarin e bërë nga vajza e subjektit të rivlerësimit në DV-2014, me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, dhënë gjatë hetimit administrativ. Pas këtyre shpjegimeve të nivelit deklarativ të subjektit, rezulton se Komisioni i ka konsideruar këto të ardhura si të ardhura të ligjshme, duke i përfshirë në analizën e tij financiare. Shumat prej 3.500 euro dhe 100.000 lekë ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në analizën financiare të vitit 2014, pasi, nëse nuk merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme, rezulton se për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për një diferencë negative prej rreth – 503.000 lekë.

17.7.8 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursime *cash* në vlerën 1.100.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat personale. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2015 rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e këtij viti për një diferencë negative prej rreth – 830.000 lekë⁶.

17.7.9 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat e përbashkëta me bashkëshorten, si edhe ka shtuar likuiditetet në llogaritë bankare përafërsisht 1.190.000 lekë, me burim nga kursimet e viteve

⁶ Në këtë vit subjekti ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 1.100.000 lekë ndërkohë, ka depozituar dhe në llogarinë bankare kursimet përafërsisht 2.000.000 lekë.

të mëparëshme. Nisur nga diferenca negative e konstatuar në vitin 2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme, kursimet në *cash* të deklaruara, pagesat e kryera përgjatë vitit, si dhe shtimin e likuiditeteve në sistemin bankar me një diferencë negative prej rreth -1.567.000 lekë.

17.8 Në përfundim, **Komisioneri Publik** nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016, vlerëson se në kuptim të nenin D, pika 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e deklaruara dhe kursimet në formën e likuiditeteve në depozitat bankare dhe në *cash* për një diferencë totale prej rreth – 3.300.000 lekë (ose rreth 4.200.000 lekë nëse nuk konsiderojmë si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruara si dhurime⁷).

18. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare të subjektit D.Banushi për periudhën 2003-2016.

18.1 Analiza financiare është kryer duke marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur që plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës. Tek të ardhurat përfshihen, të ardhurat nga pagat, bazuar në vërtetimet e institucioneve përgjegjëse për subjektin dhe bashkëshorten, të ardhurat nga shitja e automjetit të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2005.

18.2 Në shpenzimet familjare janë përfshirë shpenzimet e jetesës, bazuar në standartin e përcaktuar nga INSTAT për ILDKPKI, për periudhën 2003-2016, llogaritur sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit. Për vitet 2014-2016, shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas përbërjes familjare duke marrë në konsideratë dhe shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për jetesën e vajzës në Tiranë për periudhën përkatëse. Shpenzimet e arredimit, ashtu edhe si Komisioni, janë llogaritur bazuar në shumën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr.1, përpjestuar për periudhën 2005⁸ deri në vitin 2012. Shpenzimet e shkollimit të vajzës janë llogaritur bazuar në deklaratat e subjektit në deklaratat periodike vjetore 2014 - 2016; Shpenzimet e shkollimit të djalit janë llogaritur bazuar në Vërtetimin nr. *** prot., datë ***.02.2019 të shkollës jopublike “****.***”, përpjestuar pagesa sipas muajve për çdo vit shkollor. Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur në përputhje me metodologjinë e Kolegjit⁹ dhe verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS. Shpenzimet për blerje pasurie (autoveturë) janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe verifikuar në dokumentacionin e paraqitur (kontratat e shitblerjes).

18.3 Në kursimet e subjektit janë përfshirë:

⁷ Depozita në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit në shumën 6.906 euro dhe 68.432 lekë, deklarohet se është krijuar nga shumat e ndryshme të deklaruara si të dhuruara për periudhën 2014-2016, për të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe pse për një pjesë prej tyre nga subjekti është identifikuar dhuruesi dhe burimi i të ardhurave (psh shtesat në depozitë në vitin 2015 dhe 2016), nuk rezulton e provuar për çdo rast dhurimi, e ardhura e ligjshme e shumës së dhuruar, në kuptim të nenit 8, pikës “g” të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

⁸ Sipas deklaratimit të subjektit ky vit përkon me periudhën që subjekti ka hyrë në banesë duke e marrë në posedim atë.

⁹ Referohuni metodologjisë së përdorur nga Kolegji në vendimin (JR) nr.11 datë 22.5.2019.

18.3.1 Kursimet *cash*, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave periodike vjetore. Në rastet kur, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet e deklaruara (në një masë mbi 50% të kursimit të deklaruar), këto kursime nuk janë marrë në konsideratë si burim për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe nuk janë përfshirë në gjendjen *cash* të akumuluar, të përdorur dhe të deklaruar nga subjekti në vitin pasardhës.

18.3.2 Kursimet në llogaritë bankare (depozita dhe llogari page) janë llogaritur sipas konfirmimeve të institucioneve financiare, bankave të nivelit të dytë, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe verifikimit të lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur.

19. Pasuria, “Apartament banimi në posedim, me sipërfaqe 85.5 m², ndodhur në lagjen “**”, Gjirokastër. (në vijim referuar si “Apartament me sip.85,5 m²”)**

19.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi në posedim, me nr.pasurie ***, me sipërfaqe 85.5 m², në titull pronësie të z.***.*** (babai i subjektit). Fituar me kontratën e shitblerjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.09.2003 dhe regjistruar në ZVRPP Gjirokastër në regjistrin hipotekor nr.***, datë ***.02.2004. Burimi i krijimit dhe vlera e pasurisë: Nuk është deklaruar.

19.2 Në DV-2003, babai i subjekti i rivlerësimit, z. ***.*** ka deklaruar: Apartament banimi “Karabina”, lagjia “****”, Gjirokastër. Regjistruar në hipotekë me nr.***, datë ***.02.2004. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat dhe kursimet e tij dhe bashkëshortes (babait të subjektit dhe të nënës së tij). Vlera: 800.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

19.3 Nga deklaratimet periodike vjetore nga DV-2004 dhe në vazhdim deri në DV-2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: si adresë banimi: “Lagjia “****”, Gjirokastër.

19.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit i ka rezultuar se¹⁰: (i) ky apartament është blerë i përfunduar dhe jo në gjendje karabina; (ii) vlera e shitjes së tij në kontratën e shitblerjes nuk përfaqëson vlerën reale të blerjes; (iii) babai i subjektit të rivlerësimit nuk justifikon me burime financiare të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me rezultatet e hetimit për këtë pasuri.

19.5 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit lidhur me faktin e blerjes së apartamentit karabina ka deklaruar¹¹ se: [...] “... Çdo provë shkresore e nxjerrë nga autoritetet shtetërore kompetente, nuk duhet marrë në konsideratë dhe nuk duhet të krijojë asnjë lloj dyshimi për të kundërtën, përse kohë që bie ndesh me realitetin faktik të gjendjes karabina të këtij apartamenti në momentin e blerjes nga babai im. Në këtë kuptim, aktit të kolaudimit nuk mund t’i jepet asnjë vlerë provuese në drejtim të vërtetimit të faktit që ky apartament ka qenë i përfunduar, pasi edhe sot, pavarësisht se ka kaluar një kohë shumë e gjatë prej 16 vjetësh, blerësi ***,***, banor i të njëjtit kat, përballë hyrjes së babait tim, e ka apartamentin e blerë prej tij në gjendje karabina” [...].

¹⁰ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit (f. 22).

¹¹ Referohuni Shpjegimeve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit (f.16).

19.6 Për të provuar faktin e blerjes së apartamentit në gjendje karabina, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion si vijon: (i) deklaratë noteriale nr.***, datë ***.01.2020, me deklarimet e shtetasit ***.***¹², administrator i shoqërisë “****” sh.p.k; (ii) foto të fasadës së pallatit¹³; (iii) foto të një apartamenti në pallat, i cili ende rezulton i papërfunduar dhe është blerë nga blerësi në të njëjtën kohë, por nuk e ka përfunduar ende këtë apartament të blerë karabina.

19.6.1 Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna dhe provave të paraqitura nga subjekti, ka arsyetuar se¹⁴: [...] “... babai i tij e ka blerë apartamentin në gjendje karabina dhe ka kryer punimet për përfundimin e tij, të cilat, sipas deklarimeve të subjektit shkojnë në total në vlerën 1.900.000 lekë. Fakti se z. ***.*** e ka blerë objektin dhe më tej ka vazhduar me ndërtimin dhe përfundimin e tij dhe se të ardhurat e përdorura e kanë burimin nga një gjendje cash kursimesh të tij nga shitja e aktivitetit blegtoral, si dhe fakti se edhe fqinjë të tjerë e kanë blerë shtëpinë në të njëjtat kushte dhe me çmime të ngjashme, krijon bindjen se deklarimet e subjektit janë të vërteta dhe pasqyrojnë gjendjen reale. Po ashtu, mbështetur në provat e administruara duket qartë se pallati është ndërtuar sipas interesave të secilit banor (referuar dritareve, grilave dhe dyerve të jashtme) dhe se ende ka një apartament në gjendje të papërfunduar, çka shton bindjen se ky pallat është shitur në gjendje karabina” [...].

19.6.2 Komisioneri Publik, si edhe në raste të tjera të ngjashme¹⁵, çmon se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe niset nga një premisë e gabuar për t’i dhënë vlerë provuese nivelit deklarativ të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket (i) gjendjes “karabina” të pasurisë në momentin e blerjes; (ii) të ardhurave të realizuara nga prindërit e subjektit, deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament me sip.85.5 m².

19.7 Lidhur me pretendimin se apartamenti me sipërfaqe prej 85.5 m² është blerë në gjendje “karabina”, Komisioneri Publik nga shqyrtimi i akteve në dosje¹⁶, i rezulton se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, për arsyet në vijim:

- (i) Nga përmbajtja e Kontratës së shitjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.09.2003, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 85.5 m² është parashikuar shprehimisht se kjo pasuri është në pronësi të shoqërisë “****” shpk dhe figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor nr.*** datë ***.01.2003. Nga përmbajtja e kontratës nuk rezulton të jetë parashikuar gjendja “karabina” apo “i papërfunduar” i pasurisë së shitur.

¹² I cili deklaron se z. ***.***, si dhe gjithë të tjerët i kanë blerë apartamentet e tyre që në fazën e karabinasë.

¹³ Foto, në të cilat, subjekti i rivlerësimit pretendon se evidentohet qartë se ngjyrat e duraluminit të dritareve dhe të dyerve, të cilat janë të ndryshme, çka tregon se ato nuk janë vendosur nga firma ndërtuese në kohën e ndërtimit të pallatit, para bërjes së aktkolaudimit, por janë vendosur më vonë nga vetë blerësit e këtyre apartamenteve. Subjekti ka paraqitur këto foto me pretendimin për të provuar se apartamentet nuk janë dorëzuar të përfunduara plotësisht “me çelësa në dorë” te blerësit, por janë dorëzuar karabina dhe përfundimi total i punimeve është bërë prej vetë banorëve të këtyre apartamenteve, pas blerjes së tyre nga firma ndërtuese.

¹⁴ Referohuni vendimit të Komisionit (f. 15).

¹⁵ Referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Komisioneri Publik, në Ankimin nr.535/6 prot. datë 22.10.2019.

¹⁶ Dokumentacioni i përcjell me shkresën nr.*** prot., datë ***.11.2019 e Drejtorisë Vendore Gjyrokastër të ASHK, drejtuar Komisionit.

- (ii) “Godina Banesë masive + lokale (lagjja “****” Gjirokaštër), ku gjendet kjo pasuri, me investitor shoqëria “****” shpk është përfuduar në vitin 2003, vërtetuar me procesverbalin e kolaudimit të inxhinieres ***.*** e datës ***.01.2003. Ky procesverbal është administruar si pjesë e dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin në ZVRPP, Gjirokaštër. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ka dalë dhe proces-verbal akt-kolaudimi datë ***.01.2003, i cili është garanci teknike dhe ligjore për dhënien e lejes së shfrytëzimit.
- (iii) Leja e shfrytëzimit nr.*** prot., datë ***.01.2003, me objekt “Godina Banesë masive + lokale (lagjja “****”), është lëshuar nga Zyra e Urbanistikës, Bashkia Gjirokaštër, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998. Kjo leje, shprehimisht përcakton se shfrytëzimi i objektit ka filluar në datë ***.01.2003, që daton para datës së blerjes së pasurisë nga babai i subjektit (***.05.2003).
- (iv) Vërtetimi nga dokumentet hipotekore që dëshmon se shoqëria “****” shpk, ka regjistruar këtë pasuri në regjistrin hipotekor nr.*** datë ***.01.2003.

19.7.1 Në përfundim të sa më sipër, *Komisioneri Publik*, konstaton se rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.*** rep nr.*** kol., datë ***.09.2003 dhe akteve të tjera zyrtare, të cilat në kuptim të ligjit përbëjnë provë të plotë se babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë pasurinë “Apartament banimi 85.5 m²”, të përfunduar plotësisht që në vitin 2003. Rezulton i pabazuar pretendimi se pasuria “Apartament banimi 85.5 m²” ishte në gjendje karabinaje në momentin e blerjes.

19.8 *Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar¹⁷ se: [...] “Në kuptim të neneve 663, 676 dhe 607 të Kodit Civil, çmimi në kontratën e shitjes përbën një kusht që përcaktohet mbi bazën e vullnetit të ndërsjellë të palëve të kësaj kontrate. Çmimi i përcaktuar në Kontratën e shitjes Nr.*** Rep., Nr.*** Kol., dt.***.09.2003 përfaqëson pikërisht vlerën e shitjes të sendit, apartamentit me sipërfaqe 85.5 m², të përcaktuar mbi bazën e vullnetit reciprok të palës shitëse, të përfaqësuar nga shtetasi ***.*** dhe palës blerëse, babait tim. Pikërisht, mbi bazën e këtij vullneti të dakortësuar me palën shitëse është përcaktuar edhe çmimi i këtij sendi” [...]. Në mbështetje të sa më sipër subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tre kontrata shitjeje¹⁸ të ngjashme, të cilat referojnë të njëjtin çmim shitje si për apartamentin në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit.

19.8.1 Komisioni, lidhur me sa më sipër ka arsyetuar se¹⁹: [...]“... në vlerësim dhe analizim mes vlerës së deklaruar prej 1.900.000 lekësh dhe vlerës prej 2.074.000 lekësh (85 m² * 24.400), e cila është vlera sipas kostos së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003, krijoi bindjen se vlera e deklaruar nga subjekti, duke marrë në konsideratë edhe provat e paraqitura prej tij, është reale dhe duhet pranuar” [...].

¹⁷ Referohuni shpjegimeve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit (f. nr.17 - 18).

¹⁸ Kontratë shitje nr. ***, datë ***.9.2003, me blerës ***.***.; kontratë shitje nr. ***, datë ***.9.2003, me blerës ***.***.; kontratë shitje nr. ***, datë ***.10.2003, me blerës *** dhe ***.***, të cilët ia kanë blerë pronares së truallit, znj. ***.***, ku evidentohet e njëjta marrëdhënie lidhur me çmimin e blerjes.

¹⁹ Referohuni vendimit (f. nr. 15 – 16).

19.8.2 *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, ashtu siç jemi shprehur edhe në pikën 19.7.1 më sipër, vlerëson se pasuria ka qenë e përfunduar në vitin 2003, dhe referuar Udhëzimit të EKB nr. 1 datë 08.05.2003 “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, rezultoi se vlera e shitjes në tregun e lirë në këtë qytet sipas po këtij udhëzimi është në vlerën 2.923.074 lekë.

19.9 *Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të subjektit* për të mbuluar me burime të ligjshme, shpenzimet për blerjen e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar²⁰ se: [...] “... të ardhurat totale të prindërve të mi nga blegtoria, vreshtaria dhe bletaria për periudhën 1991-2002, kanë qenë 4.496.120 lekë. Kjo gjendje e të ardhurave të realizuara nga prindërit e mi për këtë periudhë kohore është tregues i mundësisë së tyre financiare, jo vetëm për realizimin e blerjes së apartamentit të banimit në vlerën reale të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, por edhe në vlerën, së cilës i referohet KPK sipas Udhëzimit Nr.1, dt.08.05.2003[...].

19.9.1 Lidhur me sa më sipër subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) 9 (nëntë) Certifikata për Vërtetim Pronësie të pasurisë “Arë”²¹, në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit; (ii) 5 (pesë) Certifikata për Vërtetim Pronësie të pasurisë “Truall”²², në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit; (iii) 1 (një) Certifikatë për Vërtetim Pronësie të pasurisë pemëtores²³, në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit; (iv) Fotografi për kosheret e bletëve dhe vreshtat, në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit; (v) 2 (dy) Vërtetime pensioni të D.R.S.SH²⁴; (vi) 2 (dy) Vërtetime për të vetëpunësuarit në bujqësi lëshuar nga D.R.S.SH²⁵; (vii) 2 (dy) Vërtetime lëshuar nga Bashkia Libohovë²⁶; (viii) Vërtetim datë ***.01.2020 i Kryeplakut të fshatit ***, Gjirokastrë.

19.9.2 Komisioni, ka arsyetuar se²⁷: [...] “... Nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit, z. ***, ***, ka paguar detyrimet lidhur me sigurimet shoqërore, ka pasur tokë në pronësi dhe ka

²⁰ Referohu shpjegimeve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit (f. nr.19 - 21).

²¹ Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.09.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.968m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.09.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.2125m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.09.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.2410m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.09.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.1189m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.09.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.2060m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.01.2010, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.500 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.01.2010, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.420 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.01.2010, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.7800 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.01.2010, Pasuria Nr.***, ZK ***, arë, sip.2400 m².

²² Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.01.2010, Pasuria Nr.***, ZK ***, truall, sip.300 m² (banesa aktuale); Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.05.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, truall, sip.250 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.05.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, truall, sip.1000 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.05.2009, Pasuria Nr.***, ZK ***, truall, sip.570 m²; Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.06.2015, Pasuria Nr.***, ZK ***, truall, sip.227 m²,

²³ Certifikatë për vërtetim pronësie dt.***.06.2015, Pasuria Nr.***, ZK ***, pemtores, sip.450 m².

²⁴ Vërtetim pensioni Nr.*** Prot., dt.***.01.2020, për z.***.*** dhe Vërtetim pensioni Nr.*** Prot., dt.***.01.2020, për znj.***.*** lëshuar nga D.R.S.SH.

²⁵ Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi dt.***.12.2019, për z.***.*** dhe Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi dt.***.12.2019, për znj.***.***, lëshuar nga D.R.S.SH.

²⁶ Vërtetim Nr.*** Prot., dt.***.12.2019 (Bujqësia+Blegtoria) dhe Vërtetim Nr.*** Prot., dt.***.12.2019 (Bletari+Vreshtari) i Bashkisë Libohovë.

²⁷ Referohuni Vendimit (f. nr.16).

ushtruar aktivitet bujqësor dhe blegtoral, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues se ka blerë dhe shitur bagëti. Gjithashtu, ka paraqitur dokumentacion provues se ka pasur vreshta të mbjella me rrush, si dhe aktivitet bletarie. Shuma e kontributeve të paguara i korrespondon vlerës së pagës minimale, por i tillë ka qenë edhe vetë legjislacioni në fuqi... Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit ka realizuar aktivitetin e tij në bujqësi, blegtori e bletari, duke realizuar të ardhura nga ky aktivitet dhe se ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues, mbështetur në faktet më sipër krijoi bindjen se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe përputhen me situatën gjatë hetimit administrativ. Babai i subjektit ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003 [...].

19.9.3 *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka përlllogaritur vetë shumën e të ardhurave të sigurura nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i prindërve të tij, për periudhën 1993-2003, mbështetur në *deklarata me shkrim dore, të disa shtetasve, pa datë*²⁸. Këto të ardhura të llogaritura nga vetë subjekti, nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

19.9.4 Bazuar në dokumentacionin ligjor të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nëse marrim në konsideratë për analogji, të vetmin dokument provues mbi bazë të të cilit prindërit e subjektit të rivlerësimit mund të kenë siguruar të ardhura në nivelin e pagës minimale të të vetëpunësuarve në bujqësi, bazuar në vërtetimin mbi pagesat e kontributeve në bujqësi të prindërve të subjektit për periudhën 1993 - 2003, rezulton se totali i të ardhurave nga paga minimale²⁹ për të cilën janë paguar kontributet për këtë periudhë, është në vlerën 1.414.680 lekë (shumë kjo e konsideruar si e ardhur hipotetike). Këto të ardhura nuk mbulojnë shpenzimet për apartamentin, në asnjë nga variantet e vlerave të përlllogaritura më sipër (vlerën e deklaruar nga subjekti, vlerën sipas kostos së ndërtimit bazuar në udhëzimet e kohës së EKB, apo vlerën sipas kostos mesatare të shitjes në treg të lirë bazuar në udhëzimet e kohës së EKB për qytetin e Gjirokastrës).

19.9.5 *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e Kolegjit,³⁰ konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003.

19.9.6 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 85.5 m²”, *Komisioneri Publik* vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të

²⁸ Katër deklarata të shtetasve ***.***, ***.***, ***.***, dhe ***.***.

²⁹ Referuar të dhënave të shkresës Nr. *** prot., datë ***.11.2018, të Institutit të Statistikave, kthyer përgjigje një tjetër subjekti rivlerësimi mbi të ardhurat minimale të të vetëpunësuarve në bujqësi në rang vendi. Kemi përdorur të njejtën bazë të dhënash për të vlerësuar të ardhurat mbi pagën minimale, në rastin kur vertetohen pagesat e sigurimeve për të vetpunësuarit në bujqësi.

³⁰ Shih vendimin e KPA (JR) 12/2018 dhe vendimin (JR) 32/2019.

aneksit të Kushtetutës, provohet deklarimi i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga babai i subjektit të rivlerësimit, mbi pasurinë “Apartament 85.5 m²”.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

21. Duke ritheksuar se *Komisioneri Publik* ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Bazuar në kërkesat e nenit Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

23. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, dhe në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA